



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke



ZL.Anr.506/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkelzen Bazaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr 506/2017 e datës 24.10.2017, e parashtruar nga Shkelzen Bazaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me postë më datë 24.10.2017 nga Shkelzen Bazaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0306e/01R në bazë të pretendimeve të komisionerëve të VV, ka fituar 65 vota ndërsa në kopjen e Formularit të Rezultateve ka pasur 0 vota.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 506/2017 me datën 25.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-

